

NJOFTIM

Për: Z/Znj. _____ (Aksioner/Përfaqësues/e i/eAksionerit _____)

Për ndryshimin e rendit të ditës të mbledhjes së Asamblesë së Aksionarëve datë 26 maj 2026, sipas kërkesës së paraqitur nga Drejtoria në përputhje me Nenin 139 «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare». Pas kësaj kërkesë, mbledhja do të mbahet në orën 14.00 dhe rendi i ditës së mbledhjes datë 26 maj 2024 bëhet si më poshtë:

1. Mbi miratimin e riemërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Banka Credins sh.a. Z. Maltin Korkuti.
2. Mbi miratimin e Buxhetit të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a për vitin 2026 përparitur sipas IFRS dhe Metodologjisë së Raportimit të Bankës së Shqipërisë.
3. Mbi miratimin e Plan Biznesit të Bankës Credins sh.a për vitin 2026.
4. Mbi miratimin e rritjes së kapitalit aksionar të shoqërisë "Bankës Credins" sha në shumën 25 milion euro nga të cilat 5 milion euro do të jenë aksione me përparësi pa të drejtë vote.
5. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të shoqërisë "Bankës Credins" sha për vitin 2025 sipas IFRS.
6. Mbi miratimin e Pasqyrave Financiare të shoqërisë "Bankës Credins" sha për vitin 2025 sipas kërkesave të Bankës së Shqipërisë.
7. Mbi miratimin e Rezultatit Financiar të shoqërisë "Banka Credins" sipas IFRS dhe Bankës së Shqipërisë sh.a për vitin 2025.
8. Mbi miratimin e përdorimit të fitimit të shoqërisë "Bankës Credins" sha për vitin 2025.
9. Mbi miratimin e ekspertës kontabël të autorizuar Znj.Vera Fazlli Lala për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit aksionar të shoqërisë "Banka Credins" Sh.a nëpërmjet kalimit të fitimit të vitit 2025.
10. Miratimi i emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar për auditimin e pasqyrave financiare për vitin 2026.
11. Mbi miratimin për shitjen e aseteve të fituara në rrugë ligjore të Bankës.
12. Mbi miratimin e dhënies së bonusit për Drejtorinë në masën 1% dhe për Këshillin Drejtues në masën 0.5% të rezultatit financiar të vitit ushtrimor sipas BoA.
13. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme të Aksionarëve të Shoqërisë Credins Invest sh.a. Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive që do të zhvillohet me rend dite si më poshtë:
 1. Mbi miratimin e riemërimit të Administratorit të Përgjithshëm të Shoqërisë Credins Invest sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive për periudhën 3-vjeçare nga data 12.05.2026 deri në datën 12.05.2029".
 2. Mbi miratimin e riemërimit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit të Shoqërisë "Credins Invest" sh.a., Shoqëri Administruese e Fondeve, për periudhën 3-vjeçare nga data 24.07.2026 deri në datën 24.07.2029.

3. Mbi miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit të audituesit të pavarur, të shoqërisë administruese Credins Invest sh.a., të Fondit të Pensionit "Credins Pension", të Fondit të Pensionit "Master Pension Fund", të Fondit të Investimit "Credins Premium", të Fondit të Investimit "Credins Optimal", të Fondit "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, të Fondit "Green View Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, të Fondit të Investimit Alternativ "Credins Optimal", për vitin e mbyllur më 31.12.2025.
 4. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit për vitin e mbyllur më 31.12.2025.
 5. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të:
 - Shoqërisë Administruese "Credins Invest" sh.a.,
 - Fondit të Pensionit "Credins Pension",
 - Fondit të Pensionit "Master Pension Fund",
 - Fondit të Investimit "Credins Premium",
 - Fondit të Investimit "Credins Dynamic",
 - Fondit "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK,
 - Fondit "Green View Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK,
 - Fondit të Investimit Alternativ "Credins Optimal",
 - Fondit të Investimit Alternativ "Credins Global Bonds".për vitin financiar që mbyllet me 31.12.2026.
 6. Mbi miratimin e tekstit të draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
 7. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
14. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK që është zhvilluar me rend dite sa më poshtë:
1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë "Sea Land Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025.
 2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025.
 3. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të "Sea Land Alternative Investment Fund" Shoqëri Komandite SIK, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2025.
 4. Mbi miratimin e tekstit të draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
 5. Çështje të tjera parashikuara shprehimisht nga ligji.
15. Mbi dhënien e miratimit lidhur me përfaqësimin e Bankës Credins nga z.Maltin Korkuti në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, që është zhvilluar me rend dite sa më poshtë:
1. Mbi miratimin e raportit të auditit të pavarur, si dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025.
 2. Mbi miratimin e shpërndarjes së rezultatit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2025.
 3. Mbi miratimin e përzgjedhjes së shoqërisë audituese për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë "Green View Alternative Investment Fund", Shoqëri Komandite SIK, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2025.
 4. Mbi miratimin e tekstit të draft kontratës që do të lidhet me shoqërinë audituese.
 5. Çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji.

Jeni të lutur të paraqiteni. Ju Faleminderit.

Maltin KORKUTI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Tiranë më 19.05.2026

Sqarojmë se:

Referuar Statutit të shoqërisë dhe Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare» Aksionerët kanë këto të drejta dhe detyrime:

- Aksionarët, të cilët zotërojnë aksione, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë ose një përqindje më të vogël, të parashikuar në statut, mund t'u drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë komunikimin me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose, jo më vonë se 8 ditë përpara datës së mbledhjes së asamblesë, të kërkojnë përfshirjen e çështjeve të caktuara në rend të ditës. Në kërkesë duhet të jepen arsyet dhe objektivat, si edhe çështjet për të cilat duhet të marrë vendime asambleja e përgjithshme. Nëse kërkesa nuk është pranuar, këta ortakë kanë të drejtë të thërrasin asamblenë e përgjithshme e të vendosin çështje në rendin e ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 137 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare»

- Nëse asambleja e përgjithshme, në kundërshtim me sa më sipër, nuk thirret, ose çështja e kërkuar prej këtyre nuk përfshihet në rendin e ditës, secili prej aksionarëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse organet drejtuese nuk përmbushin kërkesat e tyre brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojnë shoqërisë blerjen e aksioneve të zotëruara prej tyre, sipas nenit 133 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, «Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare».

- Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, dhe thirrja u është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, në të njëjtat mënyra, me të cilat është kryer njoftimi i parë.

- Një aksionar mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një prokure nga një aksionar tjetër, apo nga një person i tretë.

- Administratorët dhe anëtarët e këshillit mbikëqyrës nuk mund të veprojnë si përfaqësues të aksionarëve në asamblenë e përgjithshme.

- Prokura, mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

- Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të aksionarit të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të aksionarit përfaqësuar.

- Asambleja merr vendimet nëpërmjet votimit të hapur.

- Për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës apo administratorëve, asambleja e përgjithshme vendos me votim të fshehtë, nëse kjo mënyrë votimi kërkohet nga aksionarët, të cilët zotërojnë një numër aksionesh, që përfaqësojnë të paktën 5 për qind të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

- Kopje të dokumentave dhe projekt-vendimeve bashkëlidhur me këtë njoftim do të gjeni edhe pranë Selisë së shoqërisë, nëpërmjet një kërkesë me shkrim të depozituar pranë shoqërisë "Credins Bank" sh.a.